




BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Debitimi Direkt është një instrument pagese me të cilin klienti autorizon bankën e vet përmes kompanisë të debitorit (tërheqë) mjete direkt nga llogaria bankare. Ky instrument paraqet një mënyrë të standardizuar dhe të automatizuar që është e përshtatshme për pagesa të rregullta dhe të përsëritura (rryma, telefoni, uji, ngrohja, etj.).

- Eliminon nevojën për përdorim të parave të gatshme dhe pritje në radhë për të kryer pagesa.
- Eliminon rrezikun e vonesës në kryerjen e obligimeve.
- Klienti kursen kohë dhe mban nën kontroll pagesat e veta.
- Kompania kursen kohë dhe resurse si në faturim ashtu edhe në arkëtim.
- Banka kursen kohë dhe resurse në procesimin e pagesave.



- 1 Klienti i jep (vetëm një herë) kompanisë autorizimin që i lejon asaj të tërheqë paratë nga llogaria e klientit për dobi të llogarisë së kompanisë.
- 2 Kompania përpunon autorizimin dhe ia dërgon kërkesën për Debitim Direkt bankës së klientit përmes bankës së vet. Kërkesa për Debitim Direkt përsëritet për pagesat e ardhshme.
- 3 Banka e klientit për çdo kërkesë të pranuar i transferon mjetet nga llogaria e klientit tek banka e kompanisë për dobi të llogarisë së kompanisë.



Adresa: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Rruga Garibaldi nr. 33, 10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Tel: (038) 222-055
Fax: (038) 229-253
Email: payment.systems@bqk-kos.org
Web: www.bqk-kos.org



Skema e Debitimit

Direkt

Lehtë...

Sigurt...

Shpejt...

**Sistemi i Pagesave
Ndërbankare**

DEBITIMI

DIREKT

NË KOSOVË

1. Qëllimi

Debitimi Direkt është një instrument pagese me të cilin klienti autorizon bankën e vet përmes kompanisë të debitorit (tërheqë) mjete direkt nga llogaria bankare. Skema e Debitimit Direkt ofron një qasje të lehtë, të shpejtë dhe të sigurt për kryerjen e pagesave të një kategorie të shërbimeve me vlera të ndryshueshme. Përmes Debitimit Direkt avancohet qarkullimi i pagesave duke rritur efikasitetin dhe mbajtur një kosto të ulët. Debitimi Direkt është praktik në rastet e pagesave të rregullta të cilat përsëriten në intervale kohore të caktuara, siç janë ato në lidhje me shpenzimet e rrymës, ujit, telefonit, etj.



2. Funksionimi - Veprimet

Realizimi i Debitimit Direkt mbështetet në një autorizim të cilin klienti (paguesi) ia jep bankës së vet përmes kompanisë (i paguari) me të cilën autorizohet kjo e fundit të debitorit (tërheqë) shumën e ndryshme të parave nga llogaria e klientit. Klientit i dërgohet një njoftim paraprak nga kompania për shumën dhe datën e çdo debitimi (tërheqjeje).

1 Klienti që dëshiron të kryejë pagesat periodike përmes Debitimit Direkt duhet të nënshkruajë autorizimin për kompaninë të cilës duhet t'i bëhen pagesat.

2 Kompania, e cila autorizohet nga klienti për të realizuar pagesa me Debitim Direkt, duhet ta bëjë regjistrimin e autorizimit me bankën e vet.

3 Banka e kompanisë duhet ta bëjë regjistrimin e autorizimit me bankën e klientit përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar.

Veprimet e mësipërme 1, 2 dhe 3 ndërmerren vetëm njëherë.

4 Për çdo periudhë (p.sh. muaj), kompania do të njoftojë klientin paraprakisht për shumën dhe datën e ekzekutimit të pagesës përkatëse.

5 Kompania do të dërgojë të dhënat elektronike për Debitim Direkt te banka e vet.

6 Banka e kompanisë bën verifikimin dhe përpunimin e të dhënave dhe i dërgon ato te banka e klientit në formë të kërkesës për Debitim Direkt përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar.

7 Banka e klientit bën verifikimin e të dhënave dhe e debiton llogarinë e klientit dhe shumën përkatëse e dërgon te banka e kompanisë përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar.

8 Banka e kompanisë e krediton llogarinë e kompanisë për shumën e pranuar.

Veprimet e mësipërme 4, 5, 6, 7 dhe 8 ndërmerren për çdo periudhë (p.sh. çdo muaj).

3. Përgjegjësitë e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë

Klienti (paguesi) nënshkruan autorizimin për Debitim Direkt dhe ruan korrespondencën në lidhje me të si dhe përcjell llogarinë e vet bankare.

Kompania (i paguari) i dërgon me kohë klientit njoftimin për shumën dhe datën e debitimit (tërheqjes) dhe i procedon të dhënat për inicim te banka e vet.

Banka e kompanisë verifikon të dhënat e pranuar nga kompania dhe i nis si kërkesë për Debitim Direkt përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar.

Banka e klientit verifikon dhe ekzekuton kërkesën e Debitimit Direkt përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar.

4. Roli i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) si pronare dhe operatore e Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar, administron dhe mbikëqyr Skemën e Debitimit Direkt. BQK përcakton rregullat operacionale-teknike si dhe parimet e përgjegjësisë dhe të drejtave të pjesëmarrësve në Skemën e Debitimit Direkt. BQK po ashtu autorizon dhe regjistron kompanitë pjesëmarrëse dhe mirëmban bazën përkatëse të të dhënave.

5. Mbrojtja e klientit

Klienti ka mundësi kurdoherë të kërkojë ndërprerjen (anulimin) e autorizimit të Debitimit Direkt duke njoftuar bankën e vet dhe/ose kompaninë përkatëse. Në mënyrë që të rritet siguria për klientin si pagues ai mund të përcaktojë shumën maksimale e cila mund të paguhet me Debitim Direkt. Banka e klientit nuk do të ekzekutojë kërkesën për Debitim Direkt kur shumën është më e madhe se shumën maksimale e përcaktuar nga klienti.

